



Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry Defense

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E PRISHTINËS-OPSTINA PRISTINA	REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E PRISHTINËS-OPSTINA PRISTINA
25 -03- 2022	X
14-029/01-66847/22	

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

KOMUNËS SË PRISHTINËS

DHE

MINISTRISË SË MBROJTJES

Mars, 2022.

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është ofrimi i mbështetjes nga Ministria e Mbrojtjes, përmes njësive të FSK-së, në realizimin e aktiviteteve për të cilat ka kërkuar Komuna e Prishtinës, për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së qytetarëve që mund të cenohen dhe rrezikohen nga prania e asbestit në zonën urbane, sidomos afër shkollave dhe në lagjet e urbanizuara të Prishtinës.

2. Forca e Sigurisë së Kosovës, përmes njësiteve të saj, do të merret me trajtimin e substancave të dëmshme për shëndetin e njeriut në disa pika të zonës urbane të kryeqytetit, respektivisht identifikimin e zonave dhe objekteve që përmbajnë materie të asbestit, si dhe kryerjen e procesit të ambalazhimit/ripaketimit të tij nga ekipet përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes, përkatësisht të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në kuadër të kapaciteteve teknike dhe profesionale të tyre.

3. Fokus i veçantë i trajtimit do të jenë materialet të cilat përmbajnë asbest, për të cilat Komuna e Prishtinës nuk ka kapacitete për trajtimin e tyre apo nuk ka mundësi të sigurojë kompani për trajtimin e shpejtë të tyre, ndërsa Ministria e Mbrojtjes ka kapacitete profesionale dhe teknike për trajtimin e tyre në pajtim me procedurat ligjore.

Neni 2 Përgjegjësitë e palëve

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, secila prej palëve zotohet t'i zbatojë përgjegjësitë e mëposhtme, me qëllim të realizimit sa më të mirë dhe efikas të objektivave të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi.

1. Komuna e Prishtinës do të angazhohet për:

- 1.1. identifikimin e zonave dhe të objekteve që përmbajnë substanca të rrezikshme për shëndetin e njeriut, respektivisht të asbestit, në kuadër të zonës urbane të kryeqytetit;
- 1.2. sigurimin e hapësirës dhe krijimin e terrenit për punë për ekipe profesionale;
- 1.3. nëse është e nevojshme, përcaktimin e lokacionit/pronës për zhvendosje/varrosje të materialit me substanca të rrezikshme;
- 1.4. përcjelljen e njoftimit për Ministrinë e Mbrojtjes lidhur me lokacionin ku ka dyshime që ka materiale me përmbajtje të asbestit;
- 1.5. mbështetjen teknike të ekipeve profesionale të Ministrisë së Mbrojtjes;
- 1.6. marrjen përsipër të kostos financiare të procesit të ambalazhimit, ripaketimit dhe deponimit, në pajtim me rregullat dhe procedurat ligjore;
- 1.7. brenda 14 ditëve nga nënshkrimi i këtij memorandumi të bashkëpunimit, Komuna e Prishtinës është e obliguar të njoftojë Ministrinë e Mbrojtjes me listën e lokacioneve ku ka dyshime për materiale të rrezikshme me përmbajtje të asbestit. Ekipet e Ministrisë së Mbrojtjes, përkatësisht të FSK-së, sipas kapaciteteve të tyre do të përgatisin planin operacional;
- 1.8. njoftimin e të gjitha institucioneve publike përgjegjëse për aktivitet, të cilat janë të përcaktuara në këtë marrëveshje, dhe bashkërendimin ndërmjet tyre për realizimin e aktiviteteve përkatëse.

2. Ministria e Mbrojtjes do të angazhohet për:

- 2.1. përcaktimin e ekipeve profesionale për identifikimin e materieve të rrezikshme, në kuadër të pajisjeve që posedon Ministria e Mbrojtjes;
- 2.2. kryerjen e procesit të ambalazhimit/ripaketimit të asbestit si substancë e rrezikshme për shëndetin e njeriut;
- 2.3. bartjen dhe zhvendosjen e substancave të rrezikshme në pajtim me procedurat dhe standardet e sigurisë me mbështetje të Komunës së Prishtinës;
- 2.4. kryerjen e punëve që përfshijnë ambalazhimin dhe largimin e pjesëve të dukshme të asbestit nga zona urbane e Prishtinës.

Neni 3
Afati i marrëveshjes

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit është e lidhur në afat prej dy (2) viteve nga dita e nënshkrimit, me mundësi vazhdimi sipas pëlqimit paraprak të palëve.

Neni 4
Ndryshimi dhe plotësimi i marrëveshjes së bashkëpunimit

Marrëveshja e bashkëpunimit mes palëve mund të ndryshohet dhe plotësohet me shkrim në rast nevoje, me pëlqimin e palëve.

Neni 5
Pëlqimi i palëve

Mospajtimet ose interpretimet eventuale të pikave të kësaj marrëveshjeje do të rregullohen në mënyrë miqësore, me marrëveshje konsensuale.

Neni 6
Pikat e kontaktit për koordinim dhe zbatim të marrëveshjes

1. Komunikimi ndërmjet palëve, lidhur me koordinimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të bëhet me shkrim dhe përmes formave tjera zyrtare elektronike të komunikimit.
2. Për Komunën e Prishtinës, pikë kontakti do të jetë: Seniha Bajraktari, Zyrtare e Lartë për Ambient.
3. Për Ministrinë e Mbrojtjes, pikë kontakti do të jetë: Bujar Ferizi, Kapiten.

Neni 7
Kopjet origjinale

Kjo marrëveshje është hartuar në dy (2) kopje origjinale në gjuhen shqipe, nga një (1) kopje për secilën palë.

**Neni 8
Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

PALET NËNSHKRUESE

E lidhur me datë: 25/03/2022.

Komuna e Prishtinës

Përparim RAMA / Kryetari i Komunës



Ministria e Mbrojtjes

Armend MEHAJ / Ministër i Mbrojtjes